

KËRKESË ANKIMORE

Drejtuar: Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve
Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova", Ndërtesa nr. 4: Tiranë

KQZ
 U PROTOKOLLUA
 Nr. 4823 Prot.
 Datë, më 05.05.2023

ANKUESI

Ora 18:00

Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit Koalicioni "Bashkë Fitojmë" 0697839115 / 0696178916
KOALICIONI "BASHKË FITOJMË" (BF)	

OBJEKTI I ANKIMIT

1. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 452, datë 06.05.2023 "Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 7 mars deri 2 maj 2023" ;
2. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 456, datë 06.05.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 387 nga partia socialiste e Shqipërisë, për heqje të materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga koalicioni "Bashkë Fitojmë", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023" ;
3. Ndryshimin pjesërisht të Vendimit të KSHZ nr. 452 datë 06.05.2023, duke vendosur:
 - a) Pushimin e hetimit administrativ në lidhje kërkesat për mbylljen e zyrave zgjedhore të subjektit Koalicioni "Bashkë Fitojmë" në Bashkinë Tiranë, me vendndodhje: Rr. "Artan Lenja"; Rr. "Milito Tutulani"; Rr. "Margarita Tutulani", në Bashkinë Elbasanm ,e vendndodhje pranë Universitetit "Aleksandër Xhuvani";
 - b) Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për mbylljen e zyrës së Partisë Demokratike në rrugën "Nasip Pallvo", pranë Liceut Artistik, për arsyen specifike sepse kjo zyrë nuk i takon subjektit zgjedhor PD të regjistruar në këto zgjedhje nga KQZ, por i takon entitetit politik që identifikohet me koalicionin Bashkë "Fitojmë" dhe për më tepër, kjo nuk është zyrë elektorale në kuptim të Kodit Zgjedhor, por është zyra e përhershme politike / selia e PD dega nr. 2 Tiranë;
 - c) Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për heqjen e materialeve propagandistike, në Bashkitë Durrës dhe Tiranë, në lidhje me subjektin Koalicioni "Bashkë Fitojmë", në shtylla ndriçimi, në rrugën "Veli Dedi, Bashkia Tiranë.
4. Ndryshimin e vendimit të KSHZ Nr. 456, datë 06.05.2023, duke vendosur: Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me heqjen e menjëhershme të materialit



[Signature]

propagandistik mbi fasadën e godinës së Postës Shqiptare në Kavajë, të subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.	
Vendimi	<u>TITULLI I VENDIMIT</u> Vendimi 404, datë 24.04.2023 “Caktimin E Partive Politike Që Do Të Propozojnë Anëtarin e Tretë dhe të Katërt të Grupeve të Numërimit të Votave, Për Zgjedhjet Për Organet e Qeverisjes Vendore Të Datës 14 Maj 2023”
Nr.	Datë
452 & 456	06/05/2023
BAZA LIGJORE:	
Neni 4, pika 1 e Kushtetutës së Shqipërisë; Nenet 19, Neni 79, nenet 136, 139, 140, 141, si dhe Neni 183 e vijues të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.	

PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin e tij nr. 452, datë 06.05.2023 ka vendosur :

1. Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për mbylljen e menjëherëshme të zyrave zgjedhore, në Bashkitë Durrës, Kavajë, Kukës dhe Tiranë, si vijon:
 - a) Të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” në njësinë administrative Shkozet, 80 m nga qendra e votimit shkolla “Beqir Çela”, Bashkia Durrës;
 - b) Të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, afër qendrës së votimit në pallatin e Kulturës, Bashkia Kavajë;
 - c) Të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, afër qendrës së votimit shkolla “Bajram Curri”, Bashkia Kukës;
 - ç) Të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, në adresën rr. “Artan Lenja”, 150 m nga Shkolla “Gustav Mayer” dhe 170 m nga shkolla “Naim Frashëri”, Bashkia Tiranë;
 - d) Të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, në adresën rr. “Milto Tutulani”, 58 m nga Universiteti i Drejtësisë, Bashkia Tiranë;
 - dh) Të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, në adresën rr. “Margarita Tutulani”, 110 m nga shkolla “Dëshmorët e Lirisë”, Bashkia Tiranë;
 - e) Të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, 50 metra nga qendra e votimit Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Bashkia Elbasan;
 - ë) Të koalicionit “Bashkë Fitojmë”, afër qendrës së votimit shkolla “Bajram Curri”, Bashkia Kukës;
 - f) Të subjektit zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë”, në adresën rr. “Nasip Pavllo”, 180 m nga liceu “Jordan Misja”, Bashkia Tiranë.
2. Urdhërimin e Policisë Bashkiake dhe Policisë së Shtetit për heqjen menjëherë të materialeve propagandistike, në Bashkitë Durrës dhe Tiranë, si vijon:
 - a) Billborder i subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në afërsi të qendrës së votimit Pallati i Sportit “Ramazan Ngjala”, Bashkia Durrës;



[Signature]
Faqe 2 nga 5

- b) *Flamuj të subjektit zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë" në fasadë banimi, përballë shkollës së mesme profesionale "Beqir Cela" në njësinë administrative Shkozë, Bashkia Durrës;*
 - c) *Materiale propagandistike të koalicionit "Bashkë Fitojmë", në shtylla ndriçimi, në rrugën "Veli Dedi", Bashkia Tiranë;*
 - ç) *Materiale propagandistike të subjektit zgjedhor "Aleanca Progresiste LZHK", në fasadë banimi, në rrugën "Fatos Baxhaku", Bashkia Tiranë.*
3. *Ky vendim ju njoftohet subjekteve zgjedhore, Policisë së Shtetit si dhe Policisë Bashkiake nëpërmjet postës elektronike.*
4. *Ngarkohen për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake.*
5. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.*

Ndërsa me vendimin e tij nr. 456, datë 06.05.2023, KSHZ ka vendosur:

- 1. *Urdhërimin e Policisë Bashkiake Kavajë dhe Policisë së Shtetit për heqjen e menjëherëshme të materialit propagandistik mbi fasadën e godinës së Postës Shqiptare, Kavajë, të subjektit zgjedhor Koalicioni "Bashkë Fitojmë".*
- 2. *Ky vendim i njoftohet subjektit zgjedhor Koalicionit "Bashkë Fitojmë", Policisë së Shtetit si dhe Policisë Bashkiake Kavajë nëpërmjet postës elektronike.*
- 3. *Ngarkohen për zbatim të menjëhershëm të këtij vendimi Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake Kavajë.*
- 4. *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.*
- 5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij".*

Në seancën publike të datës 06.05.2023 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve z. Ilirjan Celibashi mori dy vendimet objekt ankimi, për të cilat ne si subjekt zgjedhor, Koalicioni "Bashkë Fitojmë" nuk jemi dakord sepse këto vendime na çenojnë interesat tona në këto zgjedhje.

Interesi jonë i ligjshëm çenohet nga keto vendime për sa kohë me ane të tyre është vendosur mbyllja e disa zyrave elektorale kryesisht në Tiranë, por edhe në qytetin e Elbasanit, por nga ana tjetër, me vendimet objekt ankimi KSHZ ka marrë masa ndaj nesh si koalicion edhe për heqjen e disa materialeve propagandistike në qytete të ndryshme, përfshirë qytetin e Kavajës.

Vendimet objekt ankimi rezultojnë se janë marrë nga zoti Celibashi ditën e shtunë date 06.05.2023 dhe ne si subjekt zgjedhor e sjellim këtë ankim të depozituar në datë 08.05.2023, pra brenda afateve maksimale të lejuara nga Kodi Zgjedhor (neni 125 i tij), pra brenda afatit 3-ditor nisur nga e nesërmeja e shpalljes së vendimeve objekt ankimi.

Për sa kohë ne arrijmë të provojmë se jemi subjekt zgjedhor i regjistruar në zgjedhjet e 14-majit 2023, si dhe për sa kohë kemi paraqitur ankim në KAS brenda afateve maksimale të lejuara nga ligji zgjedhor për të kundërshtuar disa vendimmarrje të KSHZ, të cilat ne gjykimin tonë, nuk janë në përputhje me faktet dhe bien ndesh me ligjin, atëherë ne çmujmë se jemi plotësisht të legjitimuar në të drejtën tonë për t'u degjuar nga KAS në seancë themeli, lidhur me pretendimet tona.



FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMIMI.

Faktet, indiciet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se vendimi i Komisionerit objekt ankimi ka ardhur në kundërshtim me realitetin e ngjarjeve dhe fakteve, ndaj vendimmarrja ka qene e vesuar e duhet kesisoj te konsiderohet nga KAS si vendime te marra ne kundërshtime me kuadrin ligjor, frymen dhe germen e ligjit.

Sikunder figuron edhe ne objekt, nje nga gabimet ndoshta materiale qe figuron ne vendimin nr. 452 te KSHZ, eshte mbyllja e zyres politike te PD prane Liceut artistik, e cila sherben jo si zyre zgjedhore, por si zyre qendrore e njesise nr. 2 Tirane te Partise Demokratike.

Pa dashur te jemi paragjykues, ne vleresojme se ky gabim mund te kete ardhur per shkak te mungeses se informacionit te mjaftueshem, gabim material apo njerezor nga ana e KQZ; Gjithsesi, mbetet fakt se kjo gje cenon funksionimin politik te deges se Tiranes, tek njesia nr. 2, per sa kohe kjo dege eshte e hapur atyre prej mbi 2-vitesh dhe nuk ka qellimin apo funksionimin e zyrave elektorale te perkohshme, por sherben per aktivitet te mirefillte politik te grupimit te PD qe ne keto zgjedhje e identifikon veten me Koalicionin "Bashke Fitojme".

Ju bejme me dije se ne date 08.05.2023 forcat e rendit kane shkuar tek zyra politike ne fjale dhe kane hartuar proces-verbalin per mbylljen e menjehershme te kesaj zyre. Ky eshte nje dem i madh qe po i shkaktohet koalicionit Bashke Fitojme ne qytetin e Tiranes.

Nga ana tjeter, deshirojme te theksojme se nje pjese e mire e atyre zyrave mund te jane perpara se te caktoheshin qendrat respektive te votimit ne ato zona. Pasi qendrat e votimit perfundimtare jane caktuar, atehere nga distanca e krijuar ka krijuar problem me zyrat tona elektorale. Ne keto kushte, ne gjykojme se keto dispozita nuk duhet te zbatohen ne rastin e ketyre zyrave elektorale.

Ndaj përfundimisht, bazuar edhe mbi argumentat qe i rezervojme vetes per t'i shtjelluar gjatë seancave degjimore ne KAS, nga sa u argumentua më lart, Koalicioni "Bashkë Fitojme":

Kërkon:

1. **Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 452, datë 06.05.2023 "Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 7 mars deri 2 maj 2023" ;**
2. **Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 456, datë 06.05.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 387 nga partia socialiste e Shqipërisë, për heqje të materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga koalicioni "Bashkë Fitojme", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023" ;**
3. **Ndryshimin pjesërisht të Vendimit të KSHZ nr. 452 datë 06.05.2023, duke vendosur:**
4. **Pushimin e hetimit administrativ në lidhje kërkesat për mbylljen e zyrave zgjedhore të subjektit Koalicioni "Bashkë Fitojme" në Bashkinë Tiranë, me vendndodhje: Rr. "Artan Lenja"; Rr. "Milto Tutulani"; Rr. "Margarita Tutulani", në Bashkinë Elbasanm ,e vendndodhje pranë Universitetit "Aleksandër Xhuvani";**
5. **Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për mbylljen e zyrës së Partisë Demokratike në rrugën "Nasip Pallvo", pranë Liceut Artistik, për arsyen specifike sepse kjo zyrë nuk i takon subjektit zgjedhor PD të regjistruar në këto zgjedhje nga KQZ, por i takon entitetit politik që identifikohet me koalicionit Bashkë "Fitojme" dhe për më tepër, kjo nuk**

është zyrë elektorale në kuptim të Kodit Zgjedhor, por është zyra e përhershme politike / selia e PD dega nr. 2 Tiranë;

6. Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për heqjen e materialeve propagandistike, në Bashkitë Durrës dhe Tiranë, në lidhje me subjektin Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, në shtylla ndriçimi, në rrugën “Veli Dedi, Bashkia Tiranë.
7. Ndryshimin e vendimit të KSHZ Nr. 456, datë 06.05.2023, duke vendosur: Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me heqjen e menjëhershme të materialit propagandistik mbi fasadën e godinës së Postës Shqiptare në Kavajë, të subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

PROVAT QË PARAQITEN DHE / OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.

Vendimi Nr. 452 i datës 06.05.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

Vendimi Nr. 456 i datës 06.05.2023 i KSHZ.

Duke ju falenderuar paraprakisht,

KOALICIONI “BASHKË FITOJMË”

Përfaqësuar nga z. Franci NURI

Franci NURI

Franci

Tiranë, 08/05/2023

